

UDHËZIM
Nr. 295, datë 22.5.2017

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 671, DATË 6.12.2016 "
PËR PROCEDURAT E HARTIMIT TË LISTAVE TË ZGJEDHËSVE PËR ZGJEDHJET
PËR KUVENDIN" DHE UDHËZIMIN NR. 198, DATË 27.3.2017 "PËR PROCEDURAT E
HARTIMIT TË LISTAVE TË ZGJEDHËSVE PËR ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PËR
KRYETAR TË BASHKISË KAVAJË, QARKU TIRANË"

Në zbatim të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 49, 50 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të dekretit nr. 10351, datë 21.5.2017 të Presidentit të Republikës, "Për një ndryshim në dekretin nr. 9883, datë 5.12.2016 "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin", si dhe të dekretit nr. 10352, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për kryetar bashkie, bashkia Kavajë, qarku Tiranë", me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,

UDHËZOJ :

1. Data e zgjedhjeve 18.6.2017 për Kuvendin, zëvendësohet me datën 25.6.2017.
 2. Pika 19 ndryshohet si më poshtë:
"Çdo zyrë e gjendjes civile në bashki, më datë 24.5.2017 printon nga RKGJC, tri formatet "a", "b" dhe "c" të listave të zgjedhësve, për çdo qendër votimi, duke përfshirë edhe institucionet e posaçme, nën juridiksionin territorial të saj, të cilët gjithashtu duhet të hartojnë listën e zgjedhësve sipas parashikimeve të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".
 3. Pika 20, ndryshohet si më poshtë:
"Kryetari i Bashkisë miraton dhe firmos formatet e listave "a" dhe "b" të parashikuara nga Kodi Zgjedhor dhe i dërgon ato brenda datës 25.05.2017 në KZAZ- në përkatëse", ndërsa formati "c" i dërgohet KQZ-së, nga ana e DPGJC-së, në format elektronik.
 4. Pika 21 hiqet.
 5. Për zgjedhësit e bashkisë Kavajë, është e vlefshme lista e cila do të printohet sipas pikës 3 të këtij udhëzimi, e cila të përdoret për zgjedhjet për Kuvendin dhe zgjedhjet për kryetarin e bashkisë Kavajë.
 6. Udhëzimi nr. 198, datë 27.03.2017 "Për procedurat e hartimit të listave të zgjedhësve për zgjedhjet e parakohshme për kryetarë të bashkisë Kavajë, qarku Tiranë, shfuqizohet.
 7. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, përgjegjësit e zyrave të gjendjes civile në njësitë administrative, si dhe institucionet e tjera shtetërore që parashikohen në Kodin Zgjedhor.
- Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Fatmir Xhafaj

